32. Kryetari mund, me pëlqimin e ortakëve në mbledhje, të shtyjë çdo takim nga një anë në një tjetër apo nga një vend në një vend tjetër, por në mbledhjet e shtyra, nuk do të trajtohen biznese të tjera përveç atyre të lëna të pa përfunduara në mbledhjen e shtyrë.

33. Në çdo mbledhje vendimi i hedhur në votë do të votohet duke ngritur duart me shumicë të thjeshtë nëse një nuk kërkohet një votim me deklaram personal gojor (përpara apo në deklaratën e rezultatit me ngritje duarsh):

(a) nga kryetari; ose

(b) nga çdo ortak i pranishëm personalisht dhe me prokurë që përfaqëson të paktën 1/10 e totalit të të drejtave të votave të të gjithë ortakëve me të drejtë vote të pranishëm në mbledhje.

34. Me përjashtim të rasteve kur kemi një votim me deklaram personal gojor, deklarimi nga kryetari se vendimi është marrë me ngritje duarsh, dhe regjistrimi i tij në librin që përmban protokollin e mbledhjeve të Shoqërisë do të jetë një provë e mjaftueshme pa pasur nevojë për të provuar numrin apo përqindjen e votave të regjistruar në favor apo kundër një vendimi të tillë.

35. Nëse një votim në deklarimin personal gojor kërkohet ai do të kryhet sipas mënyrës së kërkuar nga kryetari dhe rezultati i votimit do të konsiderohet të jetë vendimi i mbledhjes



në të cilën u kërkuar një votim i tillë. Kërkesa për një votim me deklaram personal me mund të tërhiqet.

36. Në rast barazimi votash ose me ngritje duarsh ose me votim me deklaram personal me gojë, kryetari i mbledhjes në të cilën është kërkuar votimi me ngritje duarsh apo ai me deklaram personal me gojë do të ketë të drejtën e një votimi të dytë.

VOTAT E ORTAKËVE

37. Në çdo mbledhje të ortakëve qoftë me një votim me ngritje duarsh ose me deklaram personal me gojë çdo mbajtës i një aksioni i përfaqësuar personalisht ose me prokurë do të ketë një votë për çdo aksion me të drejtë vote të poseduar prej tij.

38. Vendimi i cili i është njoftuar të gjithë ortakëve në kohën që ata kanë patur të drejtë të votojnë dhe i cili është miratuar me shumicë të votave të atyre ortakëve në formën e një ose më shumë dokumentave të shkruara me shkrim ose teleks, telegram, ose njoftim elektronik, pa patur nevojën e një paralajmërimi tjetër do të hyjë në fuqi si një vendim i ortakëve.

39. Nëse emërohet një tutor për ndonjë ortak i cili është i paaftë mëndërisht ai mund të votojë nëpërmjet tutorit të tij.

40. Nëse dy ose më shumë persona së bashku kanë të drejtën e një ose disa aksioneve të regjistruara dhe nëse më shumë se një prej këtyre personave do të votojë personalisht ose me prokurë në çdo mbledhje të ortakëve apo në përputhje me dispozitën 37, do të merret në konsideratë vota e atij personi emri i të cilit është i pari tek bashkë-zotëruesit e aksionit.

41. Votat mund të jepen ose personalisht ose me anë të prokurës.

42. Dokumenti i caktimit të një përfaqësuesi do të paraqitet në vendin e caktuar për mbledhje përpara kohës së fillimit të mbledhjes në të cilën do të votojë përfaqësuesi i caktuar në dokumentin..

43. Dokumenti i përfaqësimit do të jetë sipas formës së pranuar nga Kryetari i mbledhjes, për të përfaqësuar dëshirat e ortakit që emëron përfaqësuesin.

44. Dokumenti i përfaqësimit do të kryhet me shkrim nga i përfaqësuari, vetëm nëse i përfaqësuari është një shoqëri apo formë tjetër personi juridik.

KOORPORATAT QË VEPROJNË NË MBLEDHJE NËPËRMJET PËRFAQËSUESVE

45. Çdo Korporatë ose formë tjetër personi juridik, që është ortak e Shoqërisë mund që me anë të një vendimi të drejtorëve të saj ose të ndonjë organi tjetër drejtues të autorizojë atë person, që e mendon të përshtatshëm të veprojë si përfaqësues të saj në çdo mbledhje të ortakëve të Shoqërisë ose të ndonjë grupi ortakësh të Shoqërisë, dhe një person i autorizuar në këtë mënyrë do të ketë të drejtën të ushtrojë të njëjtat kompetenca për llogari të shoqërisë që ai përfaqëson, ashtu siç do t'i kishte ushtruar ajo nëse do të ishte një ortak individ i Shoqërisë.



DREJTORËT

46. Me përjashtim të ndonjë modifikimi të mëvonshëm për numrin e drejtorëve, numri minimal i tyre do të jetë një dhe maksimal që do të jetë njëzet.
47. Drejtori ose Drejtorët e parë, do të zgjidhen nga nënshkruesit e Aktit të Themelimit. Më pas, drejtori(ët) do të zgjidhen nga ortakët, drejtori (nëse është vetëm një) ose drejtorët për një afat kohe të tillë sa do ta përcaktojnë këta të fundit.
48. Drejtori(ët) do të qëndrojnë në detyrë derisa pasardhësi(t) e tij(të tyre) do të fillojnë detyrën ose në rast se ndodh përpara deri në vdekjen, dorëheqjen ose largimin e tij(të tyre).
49. Çdo vend vakant në vboardin e drejtorëve mund të plotësohet nëpërmjet një vendimi të ortakëve ose të drejtorit (nëse është vetëm një), ose sipas rastit prej shumicës së drejtorëve të mbetur.
50. Derisa drejtori(ët) të emërohet(r), nënshkruesit e Aktit të Themelimit do të gëzojnë të gjitha kompetencat për të vepruar sikur të ishin drejtorë.
51. Një drejtor mund të zgjidhet ose jo nga radhët e ortakëve, por gjithsesi do të gëzojë të drejtën që të marrë pjesë dhe të ketë të drejtën e fjalës në çdo mbledhje të ortakëve dhe në çdo mbledhje të veçantë të mbajtësve të çdo klasë aksionesh në Shoqëri.
52. Një drejtor me anë të një kërkesë të nënshkruar prej tij të depozituar në Selinë e Shoqërisë, mundet të emërojë herë pas here një drejtor tjetër ose një person tjetër që të jetë zëvendësuesi i tij. Çdo zëvendësues do të ketë të drejtën të njoftohet për mbledhjet e drejtorëve si dhe të marrë pjesë në to dhe votojë si drejtor në çdo mbledhje ku drejtori që e ka emëruar atë nuk është vetë i pranishëm dhe përgjithësisht në këto mbledhje ai ka të drejta dhe ushtron të gjitha kompetencat, të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e drejtorit i cili e ka emëruar. Çdo zëvendës i tillë do të konsiderohet si drejtues i Shoqërisë dhe nuk duhet të jetë përfaqësues i drejtorit i cili e ka emëruar. Në rast se paraqiten vonesa ose vështirësi të pajustificuara në njoftimin ndaj një drejtori për një vendim, miratim i cili kërkon miratimin e tij në bazë të dispozitës 77, zëvendësuesi i tij (nëse ka), do të ketë të drejtën të nënshkruajë këtë miratim për llogari të këtij drejtori. Kompensimi i një zëvendësuesi do të jepet nga kompensimi që i paguhet drejtorit i cili e ka emëruar, dhe do të përbëjë një 1% prej kompensimit të drejtorit siç kanë rënë dakort zëvendësuesi dhe drejtori që e ka emëruar atë midis tyre. Një drejtor me anë të një kërkesë nënshkruar prej tij, dhe të depozituar në Selinë e Shoqërisë, mundet që në çdo kohë të revokojë emërimin e zëvendësuesit të tij. Në rast se një drejtor vdes ose pushon së mbajturi detyrën e drejtorit, edhe emërimi i zëvendësuesit të tij do të pushojë dhe përfundojë.
53. Drejtorët mund që me vendim të caktojnë pagesën e drejtorëve në lidhje me shërbimet e kryera ose që do të kryhen për llogari të Shoqërisë. Drejtorët gjithashtu mund të paguhet edhe për udhëtimet, hotelin si dhe shpenzime të tjera që ata mund të bëjnë për marrjen pjesë dhe kthimin nga mbledhjet e drejtorëve, ose ndonjë komiteti të drejtorëve, ose në mbledhjet e ortakëve ose, në lidhje me biznesin e Shoqërisë ashtu si do të miratohet me vendimin e drejtorëve.
54. Çdo drejtor të cilit, i kërkohet të qëndrojë ose banojë jashtë për ndonjë qëllim të Shoqërisë, ose i cili kryen shërbime, të cilat sipas opinionit të Drejtorëve i tejkalon detyrat e zakonshme të një drejtori, mund të paguhet me një kompensim shtesë (ose nëpërmjet pagës.



komisionit, pjesëmarrjes në fitim ose në një mënyrë tjetër) siç do të miratohet me vendim të drejtorëve.

55. Shoqëria mund ti paguajë një drejtor, i cili me kërkesë të Shoqërisë mban një detyrë (duke përfshirë edhe detyrën e drejtuesit), ose i ofron shërbime ndonjë shoqërie në të cilën mund të ketë interesa Shoqëria, që është kompensim (ose nëpërmjet pagës, komisionit, pjesëmarrjes në fitim ose në një mënyrë tjetër) në lidhje me këto detyra ose shërbime siç do ta miratohet me vendim të drejtorëve.

56. Posti i drejtorit do të mbetet vakant nëse ai:

(a) është larguar nga detyra me një vendim të ortakëve ose të drejtorëve, ose

(b) falimenton, ose lidh marrëveshje ose krijon lidhje me kreditorët e tij në përgjithësi; ose

(c) bëhet i paaftë mendërisht ose me shëndet të pastabilizuar sa që e bën të paaftë të menaxhojë veprimtarinë e tij; ose

(d) jep dorëheqjen nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim të drejtuar Shoqërisë.

57. (a) Një drejtor mund të mbajë çdo detyrë ose funksion tjetër fitimprurës me fitime në shoqëri (përveç detyrës së revizorit) në lidhje me detyrën e tij të drejtorit dhe mund të punojë me këtë cilësi profesionale në Shoqëri për një afat kohe sa dhe do të paguhet ose në të kundërt për aq sa është vendosur nga drejtorët.

(b) Një drejtor mund të jetë ose bëhet drejtor ose një i punësuar tjetër ose një person i interesuar në çdo shoqëri që krijohet ose drejtohet nga Shoqëria, ose për të cilën Shoqëria mund të jetë e interesuar qoftë si ortakë ose dhe ndryshe, dhe një funksion i tillë nuk do të jetë i shpërblyeshëm me para ose përfitime të tjera si drejtor ose i punësuar ose nga interesi i tij në këto shoqëri të tjera. Drejtorët gjithashtu mund të ushtrojnë të drejtat e votimit të dhëna nga aksionet që mund të kenë në ndonjë tjetër shoqëri që mbahet ose zotërohet nga Shoqëria, në atë mënyrë dhe masë siç e mendojnë ata më të përshtatshme, duke përfshirë edhe ushtrimin e tyre në favor të ndonjë vendimi që merret për të caktuar ato për të numrin e tyre, për drejtorët ose të punësuarit e këtyre shoqërive të tjera. Një drejtor mund të votojë në favor të ushtrimit të drejtave të votës në mënyrën e përshkruar më sipër, pavarësisht se ai mund të jetë ose po bëhet drejtor ose drejtues në këto shoqëri, ose në një mënyrë ose tjetër është ose po bëhet i interesuar në ushtrimin e të drejtave të votimit në mënyrën e sipërpërmendur.

(c) Asnjë drejtor nuk mund të largohet nga detyra, për shkak se ka kontraktuar me Shoqërinë qoftë si shitës, blerës ose ndryshe, dhe as me ndonjë lloj kontrate ose marrëveshje të lidhur ose për llogari të Shoqërisë në të cilën çdo drejtor është i interesuar në ndonjë mënyrë mund të konsiderohen të pavlefshme, dhe ndonjë drejtor i cili ka lidhur këtë kontratë ose është i interesuar nuk mund të jetë përgjegjës përpara Shoqërisë për ndonjë fitim të realizuar nga këto kontrata ose marrëveshje, për shkak se ky drejtor mban këtë detyrë ose të lidhjes së besimit që është krijuar mes tyre. Natyra e interesit të një drejtori duhet të deklarohet nga ai në mbledhjen e drejtorëve në të cilën çështja për të cilën lidhet kontrata ose



marrëveshja merret në shqyrtim për herë të parë, dhe në rast se drejtori nuk ishte i interesuar në lidhje me kontratën ose marrëveshjen e propozuar në datën e kësaj mbledhje, ose do të interesohet për kontratën ose marrëveshjen pasi të jetë lidhur, atëherë ai menjëherë sa i lind ky intersim duhet të njoftojë Shoqërinë me shkrim për faktin dhe natyrën e interesit të tij. Një njoftim i përgjithshëm për drejtorët e tjerë nga ky drejtor se ai është ortak i një firme ose shoqërie të veçantë, dhe se konsiderohet si i interesuar në çdo kontratë apo transaksion i cili mund bëhet pas datës së njoftimit me këtë firmë ose shoqëri (nëse një drejtor i tillë do ta deklarojë atë të njëjtin në mbledhjen e drejtorëve, ose do të marrë masa të arsyeshme për të siguruar se një gjë e tillë do të diskutohet dhe ta lexojë në mbledhjen tjetër të drejtorëve pasi të jetë dhënë) do të konsiderohet një deklaram i mjaftueshëm konflikti interesi në lidhje me këtë kontratë ose transaksion me këtë firmë ose shoqëri. Një drejtor mund të konsiderohet si ortak i kuorumit me propozimin që lidhet me ndonjë kontratë ose marrëveshje që ai mund të bëjë me Shoqërinë, ose në të cilën ai është i interesuar siç edhe përmendur më lart, dhe mund të votojë këtë propozim.

NËPUNËSIT QË KANË POZICIONE DREJTUESE

58. Drejtorët e Shoqërisë mundet që me anë të një vendimi të drejtorëve të emërojnë nëpunës në pozicione drejtuese të Shoqërisë në atë kohë që do të vlerësohet e nevojshme ose e përshtatshme, dhe këta nëpunës mund të jenë Presidenti, një ose më shumë Zëvendës-Presidentë, një Sekretar dhe një Arkëtar dhe nëpunës të tjerë, të cilët herë pas here mund të jenë të nevojshëm. Nëpunësit do të kryejnë ato detyra që do t'ju përshkruhen në kohën e emërimit të tyre, të cilat mund t'i nënshtrohen modifikimeve nga drejtorët më pas. Në mungesë të ndonjë përcaktimi të veçantë të detyrave, do të jetë përgjegjësi e Presidentit që të menaxhojë detyrat e përditshme të Shoqërisë, Zëvendës-Presidentët sipas shkalës së vjetërsisë në punë do të veprojnë në mungesë të Presidentit, por veç kësaj kryejnë disa detyra që u janë deleguar atyre nga Presidenti, Sekretari mban regjistrat, librin e Shoqërisë, të dhënat (përveç të dhënave financiare) të Shoqërisë dhe të siguron përputhjen me të gjitha kërkesat proceduriale të vëna ndaj shoqërisë nga legjislacioni i zbatueshëm, dhe Arkëtari është përgjegjës për çështjet financiare të Shoqërisë.

59. Çdo person mund të mbajë më shumë se një detyrë dhe nuk është e nevojshme që një nëpunës të jetë drejtor ose ortak i Shoqërisë. Nëpunësit do të qëndrojnë në detyrë derisa të largohen nga drejtorët, pavarësisht nëse është caktuar ose jo një pasues.

60. Çdo nëpunës që është një organ i shoqërisë mund të emërojë çdo person si përfaqësuesin e tij të autorizuar, me qëllim që t'a përfaqësojë atë dhe të bëjë transaksione të bizneseve të nëpunësve.

TË DREJTAT E DREJTORËVE

61. Biznesi i Shoqërisë do të menaxhohet nga drejtorët, të cilët mund të paguajnë të gjitha shpenzimet që janë bërë paraprakisht dhe që lidhen me krijimin dhe regjistrimin e Shoqërisë, dhe mund të ushtrojnë të gjitha këto kompetenca të Shoqërisë të cilat nuk kërkojnë nga Akti ose nga këto dispozita për t'u ushtruar nga ortakët, objekt i çdo delegimi të këtyre të drejtave siç mund të autorizohet nga këto Rregullore dhe të tilla kërkesa që siç mund të përshkruhen me anë të vendimit të ortakëve; por asnjë kërkesë e bërë me anë rezolute të ortakëve nuk do të mbizotërojë në rast se nuk është në përputhje me këto dispozita, dhe as të shfuqizojë

14
ndonjë akt të mëparshëm të drejtorëve i cili do të ishte i vlefshëm në rast se këto kërkesa nuk do të ishin bërë.

62. Drejtorët mund ti besojnë dhe ti delegojnë çdo drejtori ose nëpunësi secilin nga kompetencat e ushtruara prej tyre sipas kushteve dhe afateve si edhe me disa kufizime që ata mendojnë janë të përshtatshme, qoftë së bashku ose duke kufizuar kompetencat e tyre, dhe mundën që kohë pas kohe të revokojnë, tërheqin, alternojnë ose ndryshojnë, të gjitha ose disa prej këtyre kompetencave. Drejtorët mund t'u delegojnë disa prej këtyre kompetencave komiteteve të përbëra nga numri i ortakëve që ata e mendojnë të përshtatshëm; çdo komitet i formuar kështu duhet të ushtrojë kompetencat e deleguara tyre në përputhje me rregulloret që mund tu vendosen atyre prej drejtorëve.

63. Drejtorët mund që kohe pas kohe dhe në çdo moment të emërojnë me prokurë, ndonjë shoqëri, firmë ose person ose grup personash, qoftë direkt ose indirekt prej tyre me anë të prokurës, që të jenë përfaqësuesi ose përfaqësuesit e Shoqërisë për ato qëllime dhe me ato kompetenca, e atë autoritet, diskrecion (pa kapërcyer kompetencat që u takojnë ose që ushtrojnë vetë drejtorët sipas këtyre Rregulloreve), dhe për atë dhe në bazë të kushteve që ata konsiderojnë të përshtatshme: dhe këto prokura mund të përmbajnë dispozita për mbrojtjen dhe përshtatshmërinë e personave që veprojnë me këto prokura, ashtu si e mendojnë më të përshtatshme drejtorët dhe mund gjithashtu të autorizojnë secilin nga këta përfaqësues me të drejtën që të delegojë një pjesë ose të gjitha kompetencat, autoritetet dhe diskrecionet që i takojnë atij.

64. Çdo drejtor që është organ i Shoqërisë, mund të emërojë ndonjë person si përfaqësuesin e tij të autorizuar ligjërisht me qëllim që ta përfaqësojë atë në Mbledhjet e Drejtorëve si dhe të kryejë çdo biznes të drejtorëve.

65. Drejtorët janë të autorizuar të hapin dhe të kryejnë veprime në llogaritë bankare me bankat, zyra komisionerike, shoqatat e kursimit dhe/ose të kredisë, institutet e kredisë, ose çdo institucion tjetër i ngjashëm sipas zgjedhjes së tyre në të gjithë botën. Të gjitha çeket, premtim pagesat, kambialet si dhe të gjithë instrumentat e tjerë të negociueshme dhe të gjitha faturat për paratë e paguara Shoqërisë, do të nënshkruhen, tërhiqen, pranohen, vërtetohen ose nënshkruhen në çdo formë tjetër sipas rastit, në mënyrën që përcaktohet kohe pas kohe me vendim të drejtorëve.

66. Drejtorët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat e Shoqërisë për të marrë hua para dhe për të hipotekuar, ose për të paguar detyrimet e saj, pasuritë dhe kapital i autorizuar por i papaguar, ose çdo pjesë të tij, të lëshojnë dëftesa pagese, obligacione të shoqërisë, si dhe garanci të tjera, kudo ku Shoqëria ka marrë hua para, ose si garanci për çdo lloj borxhi, përgjegjësie ose detyrim i Shoqërisë ose të një pale të tretë.

67. Drejtorët që vazhdojnë detyrën e tyre mund të veprojnë pavarësisht nga ndonjë vend vakant në organin e tyre, me përjashtim të rastit kur numri i tyre është caktuar në dy ose më shumë persona dhe kur për arsye të vendeve vakante të ndodhura midis drejtorëve mbetet vetëm një prej tyre, në këtë rast ai autorizohet të veprojë vetëm për të emëruar një drejtor tjetër.

MBLEDHJET E DREJTORËVE

68. Mbledhjet e drejtorëve ose të ndonjë komiteti po aty do të mbahen në vendin ose vendet që do të përcaktohen nga drejtorët.



69. Drejtorët mund të zgjedhin një Kryetar për mbledhjet e tyre dhe të përcaktojnë periudhën për të cilën ai do të kryejë këtë detyrë; por nëse një Kryetar i tillë nuk është zgjedhur, ose në ndonjë mbledhje Kryetari nuk është paraqitur ndërkohë që është emëruar për një detyrë të tillë, drejtorët e pranishëm mund të zgjedhin një midis tyre për të kryer funksionin e Kryetarit të mbledhjes.

70. Drejtorët mund të mbledhen së bashku për të diskutuar të reja lidhur me biznesin, shtyrjen si dhe rregullimin e mbledhjeve të tyre si ata e mendojnë më të përshtatshme. Çështjet që ngrihen në çdo mbledhje vendosen me shumicë votash; në raste votash të barabarta kryetari do të kërkojë një votim të dytë ose votim me ngritje duarsh. Një drejtor mundet që në çdo kohë të thërrasë mbledhjen e drejtorëve. Në rast se Shoqëria do të ketë vetëm një drejtor, dispozitat që vijonë më poshtë për mbledhjet e drejtorëve nuk do të zbatohen, por ky drejtor i vetëm do të ketë të gjitha kompetencat për të vepruar dhe përfaqësuar Shoqërinë në të gjitha çështjet dhe në mungesë të procesverbalit të mbledhjes do të mbajë me shkrim dhe të nënshkruajë një shënim ose memorandum për të gjitha çështjet të cilat kërkojnë një vendim të drejtorëve. Ky shënim ose memorandum do të përbëjë një provë të mjaftueshme për këto vendime për të gjitha qëllimet.

71. Një drejtor duhet të njoftohet jo më pak se 7 ditë përpara mbledhjes së drejtorëve.

72. Pavarësisht nga Rregulli 71 më sipër, një mbledhje e drejtorëve e mbajtur në kundërshtim me këtë Rregull, do të jetë e vlefshme vetëm në rast se shumica e drejtorëve që kanë të drejtën e votës kanë hequr dorë nga njoftimi i mbledhjes.

73. Mosnjoftimi i një drejtori për mbledhjen e drejtorëve, ose i faktit se një drejtor nuk e ka marrë njoftimin, nuk e bën mbledhjen të pavlefshme.

74. Një mbledhje e drejtorëve është rregullisht e mbledhur për të gjitha qëllimet në rast se në fillim të mbledhjes janë të pranishëm personalisht ose të përfaqësuar të paktën shumica e numrit të përgjithshëm të drejtorëve.

75. Nëse brenda gjysëm ore nga koha e caktuar për fillimin e mbledhjes kuorumi nuk është i pranishëm atëherë mbledhja shpërndahet.

76. Çdo drejtor ose disa prej drejtorëve ose ndonjë komitet i tyre mund të marrë pjesë në një mbledhje të drejtorëve ose në një komitet të drejtorëve me anë të një konference telefonike, ose ndonjë mjeti tjetër të ngjashëm komunikimi që u jep mundësi të gjithë personave pjesëmarrës në mbledhje të dëgjojnë njëri-tjerin, në të njëjtën kohë. Pjesëmarrja me anë të këtyre mjeteve do të konsiderohet sikur ka qenë i pranishëm personalisht në mbledhje.

77. Një vendim i miratuar nga shumica e drejtorëve për kohën në të cilën kanë pasur të drejtë të marrin njoftim për mbledhjen e drejtorëve ose të komitetit të drejtorëve dhe marrjen e një ose më shumë dokumentave në formën me shkrim ose teleks, telegram, ose me çdo formë tjetër komunikimi elektronik do të jetë i vlefshme dhe efektiv nëse është kaluar në një mbledhje drejtorësh ose në një komitet të mbledhur rregullisht, pa qenë nevoja e ndonjë njoftimi.

DËMSHPËRBLIMI

78. Në përputhje me dispozitat e këtij Akti dhe të çdo ligji apo rregulloreje tjetër për kohën në të cilën është në fuqi, çdo drejtor ose nëpunës tjetër i Shoqërisë do të ketë të drejtën të dëmshtëpërblehet nga asetet e Shoqërisë kundrejt të gjitha humbjeve ose përgjegjësi të cilat ai mund t'i kryejë ose ti ndodhin ose gjatë kryerjes së detyrave të pozicionit të tij ose që ndryshe lidhen me funksionin e tij, dhe se asnjë drejtor ose nëpunës tjetër nuk është përgjegjës për ndonjë humbje, dëmtim ose fatëkeqësi që mund të ketë ndodhur ose mund të ndodhë Shoqërisë gjatë kryerjes së detyrave të tij, ose që lidhen me to.

VULA

79. Drejtorët duhet të kujdesen për ruajtjen e vulës së përbashkët të Shoqërisë. Vula e përbashkët e vendosur mbi çdo dokument përveç rasteve të parashikuara në Rregullin 3, do të vërtetohet nga një drejtor ose nga një person tjetër i autorizuar kohe pas kohe nga drejtorët. Drejtorët mund të bëjnë një kopje të vulës së përbashkët dhe të miratojnë që firma e çdo drejtori ose personi të autorizuar, mund të riprodhohet nëpërmjet printimit ose me mjete tjera në çdo dokument dhe do të ketë të njëjtën fuqi dhe vlefshmëri sikur vula të ishte vënë mbi këtë dokument dhe dokumenti të ishte firmosur si në mënyrën e përshkruar më sipër.

DIVIDENTËT DHE REZERVAT

80. Drejtorët mund të deklarojnë me anë të vendimit një dividend, por asnjë dividend nuk mund të deklarohet dhe paguhet derisa drejtorët të përcaktojnë se menjëherë pas pagesës së dividendit:

- (a) Shoqëria do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet e saj kur ato bëhen të detyrueshme në rrjedhën e zakonshme të biznesit; dhe
- (b) vlera e realizuar nga asetet e Shoqërisë nuk do të jetë më vogël se shuma e përgjithshme e detyrimeve të saj, përveç taksave të paguara me kështu, siç tregohet në librat e llogarisë, dhe në kapitalin e tij.

81. Dividentët mund të deklarohen dhe të paguhen në para, aksione, ose pasuri tjetër.

82. Në llogaritjen e tepricave me qëllim vendimin për të deklaruar dhe paguar një dividend, drejtorët mund të përfshijnë në mbledhjen e tyre vlerën neto të parealizuar prej aseteve të Shoqërisë.

83. Drejtorët mund që nga koha në kohë t'u paguajnë ortakëve dividendë të përkoreshëm për të cilat drejtorët mendojnë që mbulohen nga tepricat e Shoqërisë.

84. Në përputhje me të drejtat e aksionerëve që kanë të drejta të veçanta dividendesh, të gjithë dividendët do të deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumën e paguar për aksionet e emetuara, duke përjashtuar ato aksione që mbahen nga Shoqëria si aksione të Thesarit në datën e deklarimit të dividendit.

85. Drejtorët mund të lënë jashtë të ardhurave të Shoqërisë, përpara se të rekomandojnë çdo dividend, ato shuma që ata mendojnë se duhet të jenë rezervë ose rezerva që, me zgjedhjen e drejtorëve, do të zbatohen për mbledhjet e paparashikuara, ose për çdo qëllim tjetër për të cilin të ardhurat e Shoqërisë mund të përdoren dhe gjatë një përdorimi të tillë



mund të përdoren në biznesin e Shoqërisë ose të investohen në ato investime siç e mendo në të përshtatshme drejtorët.

86. Në rast se disa persona janë regjistruar si bashkëpronarë të ndonjë aksioni, çdonjëri prej tyre mund të japë një faturë të vlefshme për çdo dividend ose shuma të tjera të pagueshme në para ose që lidhen me aksionet.

87. Në rast të aksioneve të emetuara për tek prurësi, drejtorët mund të kujdesen për pagimin e një dividenti duke iu referuar faturës, ose garancive të lëshuara me certifikatën për këto aksione, dhe paraqitja e një dividenti të tillë, fatura ose garancia do të provojë të drejtën për të marrë këto dividendë në të njëjtën masë sa dhe e ardhura e vet certifikatës. Në kohën e paraqitjes së faturës ose garancisë, drejtorët mund të lëshojnë fatura ose garanci të tjera siç mund të kërkohej për të lejuar marrjen nga aksioneri të dividendëve të mëvonshëm.

88. Njoftim: për çdo dividend që mund të jetë deklaruar duhet ti jepet çdo ortakëve në mënyrën e poshtëshënuar dhe të gjithë dividendët e pakërkuar për tre vjet pasi të jenë deklaruar mund të jepen nga drejtorët në favor të Shoqërisë.

89. Asnjë dividend nuk do të japë interes kundër Shoqërisë.

LIBRAT DHE TË DHËNAT

90. Shoqëria do të mbajë disa llogari dhe të dhëna sa drejtorët e vlerësojnë të nevojshme, me qëllim që të pasqyrojnë gjendjen financiare të Shoqërisë.

91. Shoqëria duhet të mbajë procesuale për të gjitha mbledhjet e drejtorëve, ortakëve, komiteteve të drejtorëve, komiteteve të nëpunësve dhe komiteteve të ortakëve dhe kopje të gjithë vendimeve të marra nga drejtorët, anëtarët komitetet e drejtorëve, komiteteve të nëpunësve dhe komiteteve të ortakëve.

92. Librat, të dhënat dhe procesverbalet e kërkuara nga Rregulli 90 dhe 91, do të ruhen në Zyrën e Regjistrimit të Shoqërisë ose në ndonjë vend tjetër që mund të përcaktojnë drejtorët, dhe do të jenë të hapura për çdo kontroll të drejtorëve në çdo kohë.

93. Drejtorët duhet që kohë pas kohë të vendosin nëse dhe në çfarë mase, kohë, vende dhe në çfarë kushtesh dhe rregullash, librat, të dhënat dhe procesverbalet e Shoqërisë ose secila prej tyre do të jenë të hapura për kontroll nga ortakët që nuk janë drejtorë, dhe asnjë ortak (që nuk është drejtor) nuk do të ketë të drejtë të kontrollojë ndonjë libër, të dhënë, procesverbal ose dokument të Shoqërisë, përveç rastit kur i jepet nga Ligji ose është i autorizuar me vendim të drejtorëve.

KONTROLLI

94. Drejtorët mundin që me vendim të kërkojnë që të verifikohen llogaritë e Shoqërisë nga një ose disa revizorë ose revizorë të emëruar prej tyre kundrejt një kompensimi siç mund të bien dakort kohë pas kohe.

95. Revizori mund të jetë ortak i Shoqërisë, por jo drejtor ose nëpunës gjatë periudhës së ushtrimit të këtij funksioni prej tij.



96. Çdo revizor i Shoqërisë do të ketë të drejtën të shikojë në çdo kohë librat e llogarive dhe faturat e Shoqërisë, si dhe të ketë të drejtën të kërkojë nga çdo nëpunës i Shoqërisë informacion dhe sqarime që ai i mendon të nevojshme për kryerjen e detyrave të tij.

97. Raporti i revizorit do t'u bashkëngjitet llogarive për të cilat ai raporton, si dhe do të ketë të drejtën të marrë njoftim për dhe të marrë pjesë në çdo mbledhje në të cilën paraqiten llogaritë e humbjeve dhe fitimeve dhe bilanci i Shoqërisë.

NJOFTIMET

98. Çdo njoftim, informacion ose deklaratë e shkruar që kërkohet tu jepet ortakëve do të dërgohet:

- (a) në rastin e ortakëve të cilët mbajnë aksione të regjistruara, me postë, (shërbim ajror nëse mund të jetë i disponueshëm) që u drejtohen secilit prej ortakëve në adresat e treguara në regjistrin e aksioneve; dhe
- (b) në rastin e ortakëve të cilët mbajnë aksione tek prurësi:
 - (i) me postë (shërbim ajror nëse mund të jetë i disponueshëm) të drejtuar agentit ose avokatit emri dhe adresa e të cilit është dhënë për njoftim nga mbajtësi i aksionit (identifikuar për këtë qëllim nga numri i certifikatës së aksionit), ose
 - (ii) në mungesë të një adrese për dhënien e njoftimit, ose nëse njoftimi, informacioni ose deklarata e shkruar nuk mund të dërgohet për ndonjë arsye tjetër, duke publikuar ose njoftim, informacion ose deklaratën e shkruar në një gazetë që qarkullon në Commonwealth të Bahams dhe në një gazetë në të cilën Shoqëria ka selinë e saj.

99. Të gjitha njoftimet që u drejtohen ortakëve, në lidhje me çdo aksion të regjistruar që zotërohet nga disa persona së bashku, do t'i jepet njërit prej këtyre personave, emri i të cilit është i pari në regjistrin e aksioneve, dhe një njoftim i dhënë në mënyrë të tillë do të jetë i mjaftueshëm për të gjithë zotëruesit e këtij aksioni.

100. Çdo njoftim, i bërë me postë, do të konsiderohet si i bërë brenda 10 ditëve nga postimi, dhe për të provuar një gjë të tillë do të jetë e mjaftueshme të provohet se letra që përmban njoftimin ishte adresuar, vulosur dhe e hedhur në kutinë e postës në kohën dhe mënyrën e duhur.

PENSIONET DHE FONDET PËR PENSION

101. Drejtorët mund të krijojnë dhe mbajnë ose të sigurojnë krijimin dhe mbajtjen e ndonjë fondi për pension me ose pa kontributë ose jokontribues ose të fondeve për pension, për përfitim të si dhe të japin ose të sigurojnë dhënien e donacioneve, pensione, pagat e personave të cilëve janë ose ishin në çdo kohë të punësuar ose të në shërbim të Shoqërisë, ose në ndonjë shoqëri e cila është filial i Shoqërisë, ose bashkëpunon me Shoqërinë ose me ndonjë filial të tillë, ose me ata që janë ose ishin në çdo kohë drejtorë ose nëpunës të Shoqërisë ose të ndonjë kompanie tjetër të sipërpërmendur ose të cilët paguhet ose janë paguar si persona të punësuar ose si persona që kryejnë detyra të rëndësishme në Shoqëri ose në ndonjë shoqëri tjetër, ose ndonjë person tjetër tek i cili ka patur përfitime Shoqëria ose çdo shoqëri tjetër e sipërpërmendur është ose ka qënë e interesuar në çdo kohë, dhe për gratë e



veja dhe burrat e vejë, familjet dhe personat që janë në varësi të këtyre personave, dhe mund të bëjnë pagesa për të siguruar ndonjë prej personave të sipërpërmendur, si dhe mund të kryejë çdonjërin prej sa më mësipër si vetëm ashtu edhe së bashku me ndonjë nga shoqëritë e sipërpërmendura. Një drejtor që kryen këtë punë ose ka këtë detyrë gëzon të drejtën të marrë pjesë në dhe të mbajë për përfitim të tij ndonjë nga këto donacione, pensionin, pagesa ose bonuse.

SHPËRNDARJA DHE MBYLLJA

102. Në rast se Shoqëria do të shpërndahet, Likuidatori në përputhje me vendimin e orëtakëve, mund të ndajë midis ortakëve qoftë në kontribut në para ose në natyrë, të gjithë ose edhe një pjesë të aseteve të Shoqërisë (pavarësisht nëse ato janë pasuri e të njëjtit lloj ose jo) dhe mund për këtë qëllim të vendosin një vlerë të tillë siç e mendojnë të përshtatshme për çdo pasuri që do të ndahet siç është treguar më lart si dhe mund të vendosin se si do të bëhet kjo ndarje midis ortakëve ose ortakëve të kategorive të ndryshme. Likuidatori mund përdorë të gjithë asetet ose një pjesë të tyre nën kujdes në favor të kontribuesve ashtu si ai do ta mendojë më të përshtatshme, por në atë mënyrë që asnjë ortak të detyrohet të pranojë ndonjë aksion ose letra me vlerë të tjera të cilat nuk janë të lira nga ndonjë barrë.

ARBITRAZHI

103. Kurdo që lindin mosmarrëveshje midis Shoqërisë në njërën anë dhe ndonjë prej ortakëve, ekzekutorëve të tyre, administratorëve, ose të transferuarve të tyre nën tjetër, prekin synim e vërtetë dhe strukturën ose lënë pasoja që lidhen me këtë Akt ose që Akti prek ndonjë gjë të bërë ose të kryer ose të dëmtuar në përputhje me Aktin, ose prek ndonjë shkelje ose tjetër që lidhet me kushtet paraprake ose me këtë Akt ose me ndonjë Akt që ndikon në Shoqërinë ose në ndonjë nga çështjet e Shoqërisë derisa palët të bien dakord se do të referohen të njëjtit arbitër ose dy arbitra, një i zgjedhur nga secila prej palëve dhe arbitrat përpara se të fillojnë gjykimin caktojnë një kryetar.

104. Në rast se secila prej palëve dështon në emërimin e një arbitri si në fillim kryesisht ashtu edhe në zëvendësim, (në rastin që ndonjë prej arbitrave të emëruar mund të vdesë, bëhet i paafte për të vepruar, ose refuzon të veprojë) për dhjetë ditë pasi pala tjetër i ka bërë njoftimin për të caktuar një arbitër, pala tjetër mund të emërojë një arbitër tjetër për të vepruar në vend të arbitrit që mungon të palës tjetër.

NDRYSHIMI I NENEVE

105. Shoqëria mund të ndryshojë ose modifikojë kushtet që përmbahen në këto rregulla siç janë shkruar në origjinal ose siç ndryshohen nga herë pas here, me anë të një vendimi qoftë të ortakut(ëve) ose të drejtorit(ëve) të Shoqërisë.



EMRI, ADRESA DHE PËRSHKRIMI I NËNSHKRUESVE

(nënshkrimi)

Ndihmës Sekretar

MOSSFON NOMINEES INTERNATIONAL LTD.

P.O.Box 156

Hibiscus Square

Grand Turk

Turks and Caicos Islands

(nënshkrimi)

MOSSFON NOMINEES INTERNATIONAL LTD.

P.O.Box 156

Hibiscus Square

Grand Turk

Turks and Caicos Islands

Datë, 17 Nëntor 1999.

Vërtetoj nënshkrimët e mësipërme:

(nënshkrimi)


Dave Taylor

Unë vërtetoj se kjo është një kopje e vërtetë e origjinalit depozituar në Regjistrin e Shoqërive.

Datë, 17 Nëntor, 1999

W. Renae McKay

Noter Publik



VËRTETIM I PËRKTHIMIT

Unë vërtetoj se sot, më 5/4.2000, deklarova se versioni Shqip i dokumentit bashkangjitur është një përkthim i saktë i versionit Anglisht dhe anasjelltas.

Xhexhi
PËRKTHEYESE
Entela Xhexhi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NOTERIA TIRANË

Nr. 670 Rep.

Nr. - Kol.

VËRTETIM

Vërtetoj se sot më datë 5/4.2000, para meje notere Lindita Lleshi u paraqit Entela Xhexhi, e njohur personalisht prej meje, madhore, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, e cila më deklaroi se e ka përkthyer dokumentin bashkangjitur nga anglishtja në Shqip njëllor me originalin dhe e nënshkroi atë para meje noterit dhe unë e vërtetoj sipas ligjit.

NOTERE
Lindita Lleshi

PULLE TAKSE

